



Në bazë të nenit 12 dhe nenit 17, të Ligjit nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 19.2 dhe nenit 38 të Ligjit për transportin rrugor, nr. 2004/1, nenit 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 569/1 të datës 16.12.2010, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 28 shkurt 2013 miratoi:

RR E G U L L O R E N
PËR
USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË TRANSPORTIT TAKSI TË UDHËTARËVE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Rregullore, rregullohet mënyra e kryerjes dhe e organizimit të transportit të udhëtarëve me taksi në territorin e komunës së Rahovecit (në tekstin e mëtejme –Komuna) caktimi i numrit të taksive dhe i stacioneve për taksi, mënyra e shfrytëzimit të tyre, rregullimi, mirëmbajtja dhe numri i automjeteve në stacionet e taksive, të drejtat dhe detyrat e drejtuesve të automjeteve taksi, si dhe të personave që transportohen, kushtet themelore dhe plotësuese që duhet plotësuar drejtuesi i taksisë dhe automjeti taksi, si dhe çështjet tjera në përputhje me Ligjin për transportin rrugor.

Neni 2

Përkufizimet

Komuna – është njësi themelore territoriale e vetëqeverisjes lokale në Kosovë.

Licenca - e drejta për të kryer veprimtarinë e transportit të rregullt të udhëtarëve.

Leje - dokumenti me të cilin lejon transportin brenda dhe jashtë Kosovës të udhëtarëve.

Operatori i transportit – është person juridik apo fizik i cili ushtron veprimtarinë e transportit publik.

Drejtuesi i automjetit – personi i cili e ka fituar shkallën e nevojshme të kualifikimit për drejtimin e një mjete motorik.

Auto taksi – transporti jashtë linjor i udhëtarëve i cili kryhet me automjetet e udhëtarëve dhe i cili i plotëson standardet.

Vendndalimi – është lokacion i përcaktuar ku i mundësohet automjeteve për transportin e udhëtarëve për të marrë dhe për të zbritur udhëtarë.

Tarifë – është akt i cili përmban çmimin lidhur me transportin dhe kushtet tjera transportuese.

Neni 3

1. Rregullimin, punët administrative dhe organizimin e transportit taksi të udhëtarëve e bën Drejtoria e Shërbimeve Publike Komunale dhe Emergjencë, në përputhje me nevojat për transport dhe me zhvillimin e planifikuar të komunës.

2. Kërkesat për kryerjen dhe vazhdimin e veprimtarisë së transportit taksi, i drejtohen Drejtorisë për Shërbime Publike Komunale për Emergjencë e cila është kompetente për komunikacion (trafikun) pranë Kuvendit të Komunës .

3. Kërkesës i bashkëngjiten edhe dëshmitë mbi plotësimin e kushteve të parapara sipas kësaj Rregulloreje.

4. Lejen për ushtrimin e veprimtarisë së transportit me taksi e lëshon Drejtoria e Shërbimeve Publike Komunale dhe Emergjencë.

Neni 4

Transporti taksi është transport publik i personave në transportin jo të rregullt (jashtë linjor) rrugor, për të cilin çmimi për rrugën e kaluar është që më parë i njohur dhe përcaktohet në bazë të taksimetrit, sipas çmimoreve të shërbimeve.

Neni 5

1. Transporti taksi i udhëtarëve mund të kryhet vetëm me automjet me **5 (4+1) ulëse** dhe i cili ka së paku pesë dyer.

2. Përgjashtimisht nga **paragrafi 1 i këtij neni**, sipas nevojës brenda territorit të komunës, transporti taksi mund të kryhet edhe me automjete me **8+1** ulëse pa taksimetër.

3. Automjeti, sipas **paragrafit 1 dhe 2** të këtij neni, nuk mund të ketë mjet për bartje (rimorkio).

Neni 6

1. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve pa lejen e lëshuar nga organi kompetent që është përcaktuar në **nenin 3**.

Neni 7

Transportin taksi të udhëtarëve mund ta kryejnë personat fizik, të cilët këtë e kanë profesion të vetëm dhe operatorët e transportit të cilat i plotësojnë kushtet e caktuara me ligj dhe me këtë Rregullore.

II. KUSHTET PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË TRANSPORTIT TAKSI TË UDHËTARËVE

A. Personi fizik

Neni 8

1. Përveç kushteve ligjore të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve, personi fizik duhet t'i plotësojë edhe këto kushte:

- 1.1. Të ketë lejen e drejtuesit të kategorisë "B",
- 1.2. Të jetë pronar i automjetit me të cilin ushtron këtë veprimtari,
- 1.3. Të ketë vendbanim në territorin e Komunës së Rahovecit,
- 1.4. Të ketë së pakut **dy (2) vjet** përvojë pune si drejtues i automjetit,
- 1.5. Të mos i jetë shqiptuar masa mbrojtëse e ndalimit të kryerjes së transportit taksi të udhëtarëve, më gjatë se **gjashtë (6) muaj**
- 1.6. Të ketë njohuri për qytetin,
- 1.7. Të ketë jo më shumë se **65 vjet**,
- 1.8. Të ketë certifikatën e biznesit nga **MTI** (Ministria e tregtisë dhe industrisë),
- 1.9. Të ketë certifikatën mjekësore jo më të vjetër se **1 vjet**,
- 1.10. Të ketë aparatën për zjarrfikje, të jetë i testuar çdo **gjashtë (6) muaj**,
- 1.11. Të ketë vërtetim për gjendje teknike të automjetit .

2. Dispozita e paragrafit 1 (1.5) të këtij neni nuk do të aplikohet nëse kanë kaluar një **(1) vjet** nga dita e skadimit të ndalesës.

3. Personi fizik mund të ushtrojë këtë veprimtari vetëm me automjetin e vet personal, të cilin vetë e drejton.

B. Operatori i transportit (Personi Juridik)

Neni 9

1. Për kryerjen e transportit taksi të udhëtarëve, operatori i transportit duhet t'i plotësojë këto kushte:

- 1.1. Të ketë certifikatën e biznesit për këtë lloj të transportit,
- 1.2. Që drejtuesit e operatorit të transportit të plotësojnë kushtet e përcaktuara me **nenin 8** të kësaj Rregulloreje,
- 1.3. Të jetë pronar i automjeteve të cilat i plotësojnë kushtet e parapara me këtë Rregullore,
- 1.4. Të ketë selinë në territorin e komunës së Rahovecit,

- 1.5. Të ketë vendqëndrimin e vet për automjetet me të cilat ushtron veprimtarinë taksi të udhëtarëve,
- 1.6. Të ketë sistemin e radiolidhjeve.

2. Vendqëndrimi nga **paragrafi 1 (1.5)** i këtij neni është pikënisje e automjeteve për kryerjen e transportit taksi të udhëtarëve.

III. NDËRPRERJA E PËRKOHSHME E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË TRANSPORTIT TAXI TË UDHËTARËVE

Neni 10

Drejtuesi i taksisë, përkohësisht mund të ndërpresë ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve në rastin e:

1. Pushimit mjekësor ose atij të lindjes,
2. Aftësimin profesional,
3. Shfrytëzimit të pushimit vjetor,
4. Riparimit të automjetit me të cilin ushtron veprimtarinë e transportit taksi të udhëtarëve, në kohëzgjatje prej **30 ditësh** gjatë vitit kalendarik,
5. Paraburgimit ose vuajtjes së dënimit me burg, në kohëzgjatje deri në **gjashtë (6) muaj**, si dhe për kohën sa zgjat procedura e hetuesisë përkatësisht masa e ndalimit të drejtimit të automjetit.

Neni 11

1. Kërkesën për ndërprerjen e përkohshme të ushtrimit të veprimtarisë, drejtuesi i taksisë ia parashtron **Drejtorisë së Shërbimeve Publike Komunale dhe Emergjencë**, në afat prej **pesë (5) ditësh** nga dita e paraqitjes së rrethanave nga **neni 10** i kësaj rregulloreje.
2. Drejtuesi i taksisë, po ashtu detyrohet që të rifillojë punën në afat prej **tri (3) ditësh**, nga dita e ndërprerjes së arsyeve për të cilat është lejuar ndërprerja e përkohshme e ushtrimit të veprimtarisë.

IV. NDËRPRERJA E VEPRIMTARISË SË TRANSPORTIT TAKSI TË UDHËTARËVE

Neni 12

1. Drejtuesi i taksisë e ndërpret veprimtarinë:

- 1.1 Me kërkesë për ç`regjistrim për kryerjen e veprimtarisë së transportit taksi të

udhëtarëve,

1.2 Me paraqitjen e rrethanave të cilat janë në kundërshtim me dispozitat e **nenit 8** të kësaj Rregulloreje,

1.3 Me rastin e vdekjes së taksistit.

2. Operatori i transportit detyrohet që në rastet e paraqitura nga **paragrafi 1** i këtij neni, t'i kthejë lejen e punës Drejtorisë së Shërbimeve Publike Komunale dhe Emergjencë.

V. AUTOMJETI PËR KRYERJEN E TRANSPORTIT TAKSI TË UDHËTARËVE

Neni 13

1. Automjeti për kryerjen e transportit taksi të udhëtarëve (në tekstin e mëtejme automjeti taksi), pos kushteve të përcaktuara me ligj, duhet t'i plotësojë edhe këto kushte:

1.1. Të ketë më së shumti **pesë (5) ulëse**, duke llogaritur edhe ulësen e drejtuesit të automjetit,

1.2. Të ketë së paku **pesë (5) dyer**,

1.3. Të ketë taksimetrin në gjendje të rregullt teknike, të testuar dhe të vulosur sipas kushteve të përcaktuara për taksimetër dhe i vendosur ashtu që shuma e parave të regjistruara të jetë e dukshme për udhëtarin,

1.4. Që ngrohja dhe ajrosja teknikisht të jenë në rregull,

1.5. Të ketë shenjën **"TAXI"** ose **"RADIO-TAXI"**, të vendosur mbi automjet dhe natën të jetë i ndriçuar,

1.6 Që automjeti të jetë i pastër dhe pa dëmtime,

1.7 Që reklamat dhe shenjat e ndryshme (nëse i ka) të mos jenë mbi sipërfaqen e xhamave në pjesën e përparme dhe të prapme të automjetit si dhe xhamat të mos jenë të ngjyrosur,

1.8. Të ketë aparatin kundër zjarrit të përforcuar në vend të dukshëm dhe të përshtatshëm,

1.9. Të ketë librin e faturave të destinuar për taksi - shërbime me kopje,

1.10. Që automjeti të jetë teknikisht në rregull për transportin e udhëtarëve,

1.11. Që çdo **një (1) vjet** të sjellë certifikatën për gjendjen shëndetësore,

1.12. Përveç kushteve të parapara me këtë paragraf, automjetet taksi të operatorëve duhet të jenë të ngjyrosura me ngjyrë të njëjtë.

2. Shenja **"TAXI"** dhe shenja **"RADIO TAXI"** nga **paragrafi 1 nën paragrafi 1.5.** i këtij neni, duhet të jetë e madhësisë **500x120x80 milimetra** me ngjyrë të verdhë dhe shkronja të zeza.

3. Shenja përmban: Emblemën e Komunës, shkrimi **"TAXI"** për persona fizikë dhe **"RADIO TAXI"** për operatorët e transportit dhe numrin e evidencës së automjetit taksi.

4. Shenjat plotësuese vendosen në anën e djathtë të xhamit të përparmë dhe në anën e majtë të xhamit të prapmë mbrojtës të automjetit.

Neni 14

Me automjet taksi nuk mund të transportohen:

1. fëmijët nën moshën **gjashtë (6) vjeçare** pa përcjellës, përveç nëse prindi apo kujdestari, në marrëveshje me drejtuesin e taksisë, i ka besuar fëmijën për ta transportuar deri në vendin e caktuar,
2. personat nën ndikimin e alkoolit apo drogës dhe personat e sëmurë me sëmundje ngjitëse,
3. materialet si ato: eksplozuese, radioaktive, helmuese, infektive, që ndizen lehtë dhe materiale të tjera, të cilat për shkak të vetive të veta mund të jenë të rrezikshme për sigurinë dhe shëndetin e udhëtarëve apo mund të shkaktojnë dëmtime të tjera.

Neni 15

1. Pronari i automjetit taksi i cili nuk ka leje për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve apo shenjën **"Taxi"**, përkatësisht **"Radio-Taxi"**, do të përjashtohet nga trafiku nga inspektori i trafikut rrugor, përkatësisht nga zyrtari i autorizuar i policisë ashtu që do t'i merret librezja e qarkullimit dhe targat e automjetit, në kohëzgjatje prej **48 orësh** deri në **5 (pesë) ditë**.
2. Vendimi për përjashtimin e automjetit taksi nga trafiku i dorëzohet drejtuesit aty për aty.
3. Pasojat dhe shpenzimet e krijuara, për shkak të aplikimit të dispozitës nga paragrafi paraparak i këtij neni në tërësi i bartë pronari i automjetit, përkatësisht drejtuesi.
4. Hyrja në automjet dhe dalja e udhëtarëve nga automjeti taksi nuk mund të bëhen në vendqëndrimet e autobusëve.
5. Kur drejtuesi i automjetit taksi nuk kryen transportin taksi të udhëtarëve, përkatësisht kur përdor automjetin taksi për nevoja të veta, është i obliguar që nga kulmi i automjetit të heqë shenjën **"TAXI"** apo **"RADIO-TAXI"**.
6. Automjetet taxi, të regjistruara për transportin taksi të udhëtarëve në territorin e komunave të tjera, mund të kryejnë transportin e udhëtarëve në territorin e komunës së Rahovecit në rastin kur sjellin udhëtarë nga komunat tjera, por në kthim nuk guxojnë të marrin udhëtarë të rinj, ndërkaq vetëm mund t'i kthejnë udhëtarët që i kanë sjellë.
7. Me automjet taksi nuk mund të transportohet numër më i madh i udhëtarëve nga numri i ulëseve të regjistruara në automjet, e as që mund të vendoset më vonë numër më i madh i ulëseve nga ato të regjistruara.

VI. VENDQËNDRIMET – STACIONET E AUTOMJETEVE TAKSI

Neni 16

1. Vendqëndrimi i automjeteve taksi është sipërfaqe e trafikut e destinuar për qëndrimin e automjeteve taksi gjatë punës së drejtuesve të tyre.
2. Vendqëndrimi i automjeteve taksi shënohet me shenjat horizontale dhe ato vertikale të trafikut.
3. Në vendqëndrime për automjetet taksi nuk guxon të ketë (vendosen – parkohen) automjetet tjera përpos automjeteve taksi.

Neni 17

Për mirëmbajtjen e vendqëndrimeve të automjeteve taksi, vendosjen dhe mirëmbajtjen e shenjave të trafikut kujdeset drejtoria përkatëse.

Neni 18

Vendqëndrimet, mënyrën e shfrytëzimit dhe rregullimin e automjeteve taksi i cakton Drejtoria përkatëse në bashkëpunim me shoqatën e transportuesve "TAKSI" dhe "Radio Taxi".

Neni 19

1. Në vendqëndrimet e automjeteve taksi, automjetet vendosen sipas rendit të ardhjes.
2. Drejtuesi i automjetit taksi nuk guxon të ofrojë shërbime të transportit personalisht apo përmes ndërmjetësuesit .
3. Drejtuesi i automjetit taksi mund të marrë udhëtarë për t'i transportuar jashtë vendqëndrimit të automjeteve taksi, në vendet ku nuk ndalohet parkimi dhe ndalja e automjeteve, vetëm më kërkesën e udhëtarit.

VII. TRANSPORTI ME AUTOMJETET TAKSI

Neni 20

1. Drejtuesi i automjetit taksi detyrohet të pranojë për transport secilin udhëtarë në kufijtë e ulëseve që ka në dispozicion, si dhe bagazhin e udhëtarit në kufijtë e madhësisë dhe të fuqisë bartëse të hapësirës për bagazh, përveç udhëtarëve dhe gjësendeve nga **neni 14** i kësaj Rregulloreje.
2. Drejtuesi i automjetit taksi detyrohet që ndaj udhëtarëve të sillet me kujdes dhe në mënyrë korrekte.

Neni 21

Drejtuesi i automjetit taksi obligohet që transportin ta fillojë:

- 1.nga vendqëndrimi,
- 2.sipas thirrjes telefonike ose
- 3.me radio-lidhje.

Neni 22

1. Transporti me automjetin taksi fillon me hyrjen e udhëtarit në automjet.
2. Drejtuesi i automjetit taksi detyrohet që me të hyrë të udhëtarit në automjet, ta aktivizojë taksimetritin.

Neni 23

Drejtuesi i automjetit taksi detyrohet që transportin ta bëjë nëpër rrugët publike që udhëtarit kërkon, përkatësisht nëpër rrugën më të shkurtër deri në vendin ku kërkon udhëtarit.

Neni 24

1. Drejtuesi i automjetit taksi detyrohet që gjatë kohës së udhëtimit ta vendosë lejen për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi në automjet, ashtu që ajo të jetë e dukshme për udhëtarin.
2. Drejtuesi i automjetit taksi detyrohet që gjatë udhëtimit të jetë i rregulluar (i pastër).

VIII. KOMPENSIMI PËR KRYERJEN E TRANSPORTIT TAKSI TË UDHËTARËVE

Neni 25

1. Kompensimi për kryerjen e transportit taksi të udhëtarëve përcaktohet me çmimore të shërbimeve dhe paguhet në shumën që tregon taksimetriti në vendin e arritjes së udhëtarit.
2. Në shumën e kompensimit për kryerjen e transportit taksi të udhëtarit është llogaritur edhe transporti i bagazhit. Drejtuesi i automjetit taksi është i obliguar të japë faturën për shërbimin e kryer.
3. Propozimin e çmimores nga **paragrafi 1** i këtij neni e vërteton Drejtoria e Shërbimeve Publike komunale dhe Emergjencë, në konsultim me Shoqatën e transportuesve taksi të udhëtarëve. Çmimorja duhet të jetë e vendosur në vend të dukshëm brenda automjetit.
4. Çmimi i transportit në relacionet më të gjata se **25 km**, mund të kontraktohet me marrëveshje të lirë para fillimit të transportit pa aktivizimin e taksimetritit.

Neni 26

1. Në rastin e pamundësisë së kryerjes së transportit taksit të filluar, drejtuesit të automjetit i takon si kompensim gjysma e shumës të cilën e tregon taksimetri në momentin e ndërprerjes së transportit.
2. Drejtuesi i automjetit taksit detyrohet që në rastin nga paragrafi paraparak, të sigurojë automjet tjetër për vazhdimin e transportit të udhëtarëve deri në vendin e caktuar nga udhëtarët.

Neni 27

1. Për pranimin e udhëtarëve të tjerë gjatë transportit deri te vendi i përcaktuar vendos udhëtari i cili ka filluar shfrytëzimin e transportit taksit, me pëlqimin e drejtuesit të automjetit taksit.
2. Nëse udhëtari i cili është pranuar gjatë udhëtimit vazhdon shfrytëzimin e transportit taksit edhe pas vendit të përcaktuar të udhëtarit i cili ka filluar shfrytëzimin e transportit taksit, vazhdimi i udhëtimit konsiderohet si fillim i shfrytëzimit të transportit taksit.

Neni 28

Nëse më tepër udhëtarë, shfrytëzojnë njëkohësisht transportin taksit deri në vendin e njëjtë të përcaktuar, kompensimin për kryerjen e transportit taksit e paguajnë udhëtarët në mënyrë proporcionale që e shfrytëzojnë transportin taksit.

IX. MBIKËQYRJA

Neni 29

Mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të kësaj rregulloreje e bën Drejtoria për Inspekim– Sektori për inspektim të komunikacionit rrugor dhe policia.

X. DISPOZITAT KUNDËRVAJTËSE

Neni 30

Drejtuesi i automjetit nëse bën transportin taksit të udhëtarëve në kundërshtim me dispozitën e **nenit 6**, do të gjobitet me gjobë prej **250,00 €**.

Neni 31

Me gjobë prej **150,00 €** do të gjobitet drejtuesi i automjetit taksi, nëse nuk vepron në pajtim me **nenin 14** dhe **nenin 25**.

Neni 32

1. Drejtuesit e automjeteve taksi do të gjobiten për kundërvajtje me gjobë **personat fizik** prej **150,00 € deri në 300,00 €**, ndërsa **personat juridik (operator)** **250,00 € deri 500,00 €**, nëse :

- 1.1. Bën transportin taksi të udhëtarëve në kundërshtim me dispozitat e nenit **15**,
- 1.2. Nuk gjendet në automjetin e vet derisa ai gjendet në vendqëndrim dhe nëse nuk vendos automjetin sipas renditjes së ardhjes (neni **19.1**),
- 1.3. Personalisht apo përmes ndërmjetësuesit ofron transport taksi jashtë vendqëndrimit të automjeteve taksi (neni **19.2**),
- 1.4. Vepron në kundërshtim me nenin **19** dhe nenin **21**,
- 1.5. Nuk e kryen transportin taksi nëpër rrugët të cilat i cakton udhëtari, përkatësisht nëpër rrugën më të shkurtër (neni **23**),
- 1.6. Nuk e aktivizon taksimetrit në momentin e hyrjes së udhëtarit në automjet,
- 1.7. Kompensimin për transportin e bërë e arkëton në shumë më të lartë se shuma që tregon taksimetri (neni **25**),
- 1.8. Vepron në kundërshtim me nenin **28** të kësaj Rregulloreje.

2. Për kundërvajtje nga **paragrafi 1 nën paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5 të këtij neni**, do të shqiptohet masa mbrojtëse e ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë në kohëzgjatje prej **gjashtë (6) muajsh** deri në **një (1) vit**.

Neni 33

1. Në rast se operatori transportues nuk vepron në pajtim me dispozitat e **nenit 9.1.2, nenit 13 dhe nenit 14**, do të gjobitet për kundërvajtje me gjobë deri **500,00 €**.

2. Për kundërvajtje nga paragrafi paraprak, do të gjobitet edhe drejtuesi i automjetit të operatorit transportues, me gjobë prej **100,00 €**.

Neni 34

Inspektori komunal i komunikacionit nga **neni 26.2.** dhe **29** të kësaj rregulloreje, ka autorizime të shqiptojë dënimin (gjobën) mandator për kundërvajtje në shumë prej **100,00 €**.

XI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 35

Testimin e kandidatëve për njohuritë se sa e njohin qytetin nga **neni 8.1 nënparagrafi (1.6)** e bën Drejtoria Për Shërbime Publike dhe Emergjencë.

Neni 36

Procedura sipas kërkesës për kryerjen e transportit taksi të udhëtarëve, që ka filluar e nuk ka përfunduar deri në hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, do të vazhdohet sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 37

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe publikohet në faqen zyrtare (Web Faqe) të Komunës dhe njëkohësisht e shfuqizon Rregulloren 01 Nr. 31 e datës 26.07.2002, për kryerjen e transportit me automjete auto taksi.

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT
01 Nr. 811 , më 28.03.2013.



Kryesuesi i Kuvendit

Xhemali Haxhimustafa